

MBROJTËSIT E TË DREJTAVE
TË NJERIUT NË BALLKANIN
PERËNDIMOR

RAPORT

Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut
në Ballkanin Perëndimor

Shqipëria

IMPRESSUM

Publikuar nga
Civil Rights Defenders

Për Botuesin
Goran Miletic
Drejtor për Europën

Autorësia
Armela Xhaho (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim)

Përkthimi
Ergys Bezhani

Dizajni
Marko Kovachevski

Printimi
Kontura

Numri i kopjeve
100

Ky botim është rezultat i projektit hulumtues të realizuar nga Instituti për Politikë Evropiane - Shkup për Civil Rights Defenders.



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria ka shënuar progres të ndjeshëm në promovimin dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këto arritje dhe në përparimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Megjithatë, pavarësisht progresit të shënuar deri më tani, ende është e nevojshme që Shqipëria të garantojë përputhshmëri të plotë rregullatore me standardet ndërkombëtare dhe të adresojë shqetësimet e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, të cilët janë shpesh subjekt i kufizimeve të tepruara dhe i vështirësive që cenojnë punën e tyre. Shumë nga sfidat e vazhdueshme në punën e tyre të përditshme krijohen nga kuadri i papërshtatshëm ligjor, institucional dhe politik. Ky raport evidenton disa nga sfidat që kanë përjetuar mbrojtësit e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe jep rekomandime për kapërcimin e tyre.

Studimi zbuloi se kërcënimet dhe sulmet e përjetuara nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut në Shqipëri variojnë nga fushatat e përbaltjes dhe intimidimi, dhe arrijnë deri në përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe ngacmimeve, si fizike ashtu edhe psikologjike. Megjithëse zakonisht e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në një mjedis jokufizues, ata kanë raportuar raste presioni të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga autoritetet shtetërore. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut më të rrezikuar në Shqipëri janë ata që punojnë për të mbrojtur të drejtat e komunitetit LGBTI+, të viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje, si dhe gazetarët investigativë, të cilët janë subjekt i sulmeve të shpeshta të orkestruara. Gratë Mbrojtëse të të Drejtave të Njeriut (GMDNJ) janë në veçanti subjekt i sulmeve me bazë gjinore, si intimidimi online dhe ngacmimi seksual. Hapësira për të ushtruar lirinë e shprehjes për MDNJ-të ka ardhur duke u përkeqësuar gjatë viteve të fundit, e ilustruar kjo qartësisht me prezantimin e një “pakete antishpifje”, e cila synon të rregullojë veprimtarinë e medias online. Nga ana tjetër, ekzistojnë disa mekanizma për të mbrojtur dhe promovuar punën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, si Rezoluta për Mbrojtjen e Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por ato nuk ofrojnë zbatim dhe mbrojtje efikase. Nuk ekziston asnjë ligj sipas të cilit autoritetet duhet të veprojnë me kujdesin e duhur ndaj shkeljeve kundrejt mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Sulmet, kërcënimet ose intimidimet e bëra ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut shpesh neglizhohen, shpërfillen ose nuk hetohen si duhet. Mungesa e reagimit proaktiv nga institucionet shtetërore lidhur me mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut i bën veprimtaritë e tyre mjaft të pasigurta. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut kontribuojnë ndjeshëm në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Duke pasur parasysh natyrën e punës së tyre, është thelbësore që institucionet shtetërore të garantojnë vlerësimin dhe mbrojtjen e duhur për këto grupe. Për më tepër, megjithëse Kushtetuta parashikon një sistem gjyqësor të pavarur, mbrojtësit e të drejtave të njeriut janë skeptikë për efikasitetin e hetimeve të kryera nga gjykatat shqiptare. Nivelet e larta të korrupsionit, presioni politik dhe intimidimi vijnë ende të zbehin pavarësinë e tyre dhe të cenojnë autoritetin e gjyqësorit.

Ky raport jep rekomandime për përmirësimin dhe promovimin e punës së MDNJ-ve. Autoritetet kombëtare nxiten të përmirësojnë kuadrin ekzistues ligjor dhe institucional, për të garantuar një mjedis më mundësues për mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Hapa të rëndësishme do të ishin krijimi i mekanizmave efikasë të mbrojtjes së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në rrezik, si dhe të rritet efikasiteti, transparenca dhe sensibilizimi i organeve ligjzbatuese, dhe që sistemi gjyqësor të kryejë hetime të menjëhershme, të ndjekë penalisht dhe të ndëshkojë autorët që sulmojnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme lidhur me nxitjen e përfshirjes më proaktive të medias së pavarur, komunitetit ndërkombëtar dhe shoqërisë civile për ndërgjegjësimin, forcimin dhe promovimin e rolit të MDNJ-ve.

ALBANIA

1. HYRJE

Qeveria duhet të garantojë liritë themelore dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut me çdo kusht, siç parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjet kombëtare dhe standardet ndërkombëtare.¹ Shkeljet e të drejtave të njeriut përbëjnë një kërcënim serioz për parimet bazë të një shoqërie demokratike dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut (MDNJ) po ekspozohen gjithnjë e më shumë ndaj kërcënimeve dhe sulmeve të pashmangshme për shkak të ushtrimit të detyrës së tyre. Ky raport paraqet një përmbledhje të sfidave ekzistuese dhe kufizimeve me të cilat janë përballur MDNJ-të në Shqipëri gjatë pesë viteve të fundit, duke marrë në konsideratë standardet kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Mbrojtës i të drejtave të njeriut është dikush që vepron individualisht dhe/ose në bashkëpunim me persona të tjerë, për të promovuar dhe luftuar për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.² Ky studim ka si objekt vetëm mbrojtësit e të drejtave të njeriut nga shoqëria civile, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, median, aktivistët individë dhe gazetarët. Më konkretisht, ai mbështetet në 22 intervista ballë për ballë gjysmë të strukturuara me mbrojtësit e të drejtave të njeriut, që janë aktivë në fushën e barazisë gjinore, LGBTI+, mjedisit, mbrojtjes së të dhënave, ndihmës ligjore falas, komunitetit rom dhe egjiptian, të drejtave të fëmijëve, të drejtave të punonjësve të seksit, personave që vuajnë nga HIV-i, personave me aftësi të kufizuara, si dhe gazetarëve investigativë duke mbuluar çështjet e të drejtave të njeriut, korrupsionit dhe kimit. Të gjitha intervistat u zhvilluan gjatë periudhës gusht-shtator 2019. MDNJ-të e intervistuar ishin 9 burra, 12 gra dhe 1 person transgjinnor. Ky studim nuk paraqet një analizë shteruese lidhur me situatën e të gjitha grupeve të MDNJ-ve në Shqipëri dhe gjetjet nuk duhet të përgjithësohen.

Pjesa e parë e këtij raporti, e cila trajton kontekstin e përgjithshëm dhe kuadrin rregullator lidhur me mbrojtësit e të drejtave të njeriut në Shqipëri, mbështetet në shqyrtimin e dokumentacionit, duke përfshirë dispozitat ligjore përkatëse, raportet nga OJF-të (organizatat jofitimprurëse), media dhe organet e OKB-së për të drejtat e njeriut. Pjesa e dytë, e cila analizon shkeljet dhe kufizimet me të cilat përballen mbrojtësit e të drejtave të njeriut, për sa iu përket të drejtave të tyre civile dhe politike, duke përfshirë sulmet, ngacmimin dhe forma të tjera të abuzimit, mbështetet kryesisht në intervista dhe në disa raste studimore që përfaqësojnë këto raste. Rastet studimore janë përzgjedhur duke u bazuar në përshkrimin e formave të ndryshme të pengesave, me të cilat janë përballur aktivistët e të drejtave të njeriut gjatë pesë viteve të fundit, duke përfshirë sulme në formë të shkruar, sulme verbale, dhe kërcënime dhe sulme fizike ose psikologjike. Gjithashtu, raporti sjell në vëmendje aspekte gjinore të sfidave të identifikuar, dhe rekomandon një sërë masash për mbrojtje efikase të mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

2. ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME TË KONTEKSTIT

Megjithëse mbrojtësit e të drejtave të njeriut nga shoqëria civile ndihen përgjithësisht të lirë në punën e tyre, gazetarët kanë përjetuar kufizime të ndjeshme për të shprehur opinionin e tyre ose për të raportuar lajme që kritikojnë qeverinë, institucionet ose njësitë e tyre të varësisë. Perceptimi i përgjithshëm për shoqërinë civile dhe median në Shqipëri është se ato luajnë një rol të rëndësishëm për t'i kërkuar llogari qeverisë, por përpjekjet e tyre zakonisht pengohen nga financimi i pamjaftueshëm, mungesa e kapaciteteve dhe politizimi i veprimeve të tyre. Shumica dërrmuese e të intervistuarve sugjeron se sektori i shoqërisë civile duhet të punojë më shumë për të garantuar qëndrueshmërinë e veprimeve të tyre dhe për të shtuar përpjekjet e tyre për politika dhe advokaci nëpërmjet hulumtimit të bazuar në evidenca.³ Gjithashtu, pavarësia dhe profesionalizmi i medias është pa dyshim thelbësor për të krijuar besimin dhe besueshmërinë e publikut.

Sfidat me të cilat përballen mbrojtësit e të drejtave të njeriut janë të larmishme, në varësi të natyrës së punës së tyre dhe se të drejtat e kujt po mbrojnë ata. Grupi i parë, aktivistët e LGBTI+ dhe ata që punojnë për të drejtat e punonjësve të seksit, është subjekt i sulmeve të orkestruara. Ata kanë më shumë gjasa se të tjerët që të përballen me dhunë të vazhdueshme psikologjike dhe me kërcënime anonime për sulme fizike. Gjuha e urrejtjes online kundër aktivistëve të këtij komuniteti është mjaft e zakonshme. Ka një rrezik të shtuar ndaj mbrojtësve të të drejtave të punonjësve të seksit dhe të personave transgjinnorë.⁴ Grupi i dytë, Gratë Mbrojtëse të të Drejtave të Njeriut (GMDNJ),⁵ që punojnë me viktimat e trafikimit ose rastet e dhunës në familje, është i ekspozuar ndaj rreziqeve më të mëdha të sigurisë, dhe ndodh që ndaj tyre të bëhen kërcënime të rënda nga autorët e implikuar në rastet me të cilat ato punojnë. Ato janë të ekspozuara ndaj ngacmimit të vazhdueshëm, jo vetëm për shkak të gjinisë së tyre, por edhe për shkak të punës që bëjnë. Shpesh, gratë aktiviste nuk i raportojnë kërcënimet ndaj tyre pranë autoriteteve kompetente ose i tërheqin denoncimet e tyre për shkak të frikës nga ndëshkimi.⁶ Grupi i tretë, ku përfshihen MDNJ-të, të cilët punojnë me komunitetet rome/egjiptiane, është po ashtu një shënjestër shumë e zakonshme e gjuhës së urrejtjes. Ata janë subjekt i formave të ndryshme të diskriminimit të hapur të ushtruar nga personazhet publike, në emisionet televizive dhe madje edhe nga gazetarët.⁷ Së fundmi, MDNJ-të që punojnë

1 Shpjegohen më në detaje në pjesën për kuadrin ligjor.

2 Neni 1, Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut.

3 Intervista Nr. 3, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 27.8.2019; Intervista Nr. 7, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 14.8.2019.

4 Intervista Nr. 8, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 14.8.2019; Intervista Nr. 19, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 20.9.2019; Intervista Nr. 16, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019; Intervista Nr. 9, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 18.9.2019; Intervista Nr. 20, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 23.8.2019.

5 Me GMDNJ i referohemi grave që, individualisht ose në bashkëpunim me të tjerë, veprojnë për të promovuar ose mbrojtur të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat e grave dhe çështje të barazisë gjinore, dhe, për shkak të ngjashmërive të situatave me të cilat ato përballen, termi do të përfshijë edhe mbrojtësit të të drejtave të njeriut burra dhe ata me gjini të papërcaktuar për çështje të barazisë gjinore.

6 Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019; Intervista Nr. 14, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 16, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

7 Intervista Nr. 3, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 27.8.2019; Intervista Nr. 7, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 14.8.2019.7 Intervista Nr. 4, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 13.8.2019; Intervista Nr. 10, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 18.9.2019.

për çështjet mjedisore janë përballur me shumë presion nga investitorët dhe partnerët e biznesit. Kërcënimet mund të jenë ose anonime ose të hapura, dhe synojnë të mbrojnë interesat e palëve të treta. Shpesh, këto biznese dhe investitorë mbështeten nga qeveria, gjë që shton edhe më shumë presionin për ata që ngrenë zërin kundër krimeve mjedisore.⁸

Krahas kësaj, ka disa faktorë të jashtëm që pengojnë punën e MDNJ-ve. Shkeljet dhe kufizimet e mëposhtme janë përbëjnë pengesë për punën e MDNJ-ve:

- Pamjaftueshmëria e fondeve pengon ndjeshëm punën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.⁹
- Mungesa e ndërgjegjësimit publik është një problem serioz në kontekstin shqiptar. Me kaq shumë sfida socio-ekonomike për tu përballuar, publiku i gjerë nuk i konsideron themelore temat si mjedisi ose shkeljet e të drejtave të njeriut.¹⁰
- Normat sociale dhe mendësia patriarkale vazhdojnë të shkaktojnë forma të ndryshme të dhunës.¹¹
- Pronarët e medias diktojnë se çfarë do të raportojnë gazetarët, bazuar në interesat e tyre politike dhe të biznesit.
- Qeveria ka përdorur kufizime ligjore për të sulmuar dhe heshtur opozitën që vjen nga OJQ-të/MDNJ-të¹² dhe media.
- Aktualisht, papërputhshmëritë ligjore po shkaktojnë vështirësi në mbledhjen e provave për rastet e kërcënimeve dhe diskriminimit.¹³ Ka pasur disa raste kur Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është dashur ta pushojë çështjen ose të mos kërkojë ndjekje penale për shkak të këtyre arsyeve. Të intervistuarit kanë theksuar se është mjaft e vështirë që viktimat të provojnë ose “zbulojnë” akuzat për diskriminim dhe frika që autorët të mund të hakmerren një ditë është gjithmonë e pranishme. Për më tepër, vënia e gjobave për përdorim të gjuhës diskriminuese mund të ketë efekt të kundërt dhe të nxisë më shumë gjuhën e urrejtjes.¹⁴ Rastet e diskriminimit janë të vështira për tu provuar. Koncepti i ‘barrës së provës’ në procedurën e hetimit administrativ që ndiqet nga Komisioneri nuk shpjegohet plotësisht në “Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Referuar të drejtës së subjekteve për të apeluar para Komisionerit, Ligji përcakton se aplikanti "mund të depozitojë një ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit" (Neni 33(1)). Në procedimet gjyqësore, Ligji kundër Diskriminimit shprehet se paditësi "ka detyrimin të paraqesë prova në mbështetje të padisë, duke përdorur çdo lloj prove të ligjshme që mund të provojë sjelljen diskriminuese."¹⁵ Nga ana tjetër, është Kodi i Procedurës Administrative që parashikon shprehimisht kalimin e barrës së provës tek i padituri për çështjet e diskriminimit.¹⁶
- Autoritetet nuk kanë njohuritë e duhura për të kuptuar dhe gjykuar paditë e mbrojtësve të të drejtave të njeriut me objekte të ndryshme. Për shembull, për sa u përket çështjeve mjedisore, shpesh prokurorët dhe gjyqtarët nuk dinë se si ta hetojnë një krim mjedisor. Për më tepër, Shqipëria nuk ka një laborator të çertifikuar ose të akredituar për të kryer hetime të tilla, gjë që e bën jashtëzakonisht të vështirë për shoqërinë civile që të provojë se ka ndodhur një krim mjedisor.¹⁷
- Nuk ka konsistencë dhe bashkëpunim në proceset konsultuese për hartimin e politikave dhe legjislacionit lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, proceset e konsultimit nuk përdorin qasje gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje.¹⁸

3. KUADRI LIGJOR

Shqipëria është një shtet palë në të gjitha traktatat kryesore të OKB-së për të drejtat e njeriut, dhe ka shënuar progres të ndjeshëm në ratifikimin e konventave kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,¹⁹ Konventa për të Drejtat e Fëmijës,²⁰ Karta Sociale Evropiane,²¹ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave,²² Protokolli Opsional i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave,²³ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike,²⁴ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore,²⁵ Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor,²⁶ Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese,²⁷ Protokolli Opsional i Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës

8 Intervista Nr. 11, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 22.8.2019; Intervista Nr. 6, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 13.9.2019; Intervista Nr. 5, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 14.8.2019.

9 Intervista Nr. 20, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 23.8.2019; Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019.

10 Intervista Nr. 6, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 13.9.2019; Intervista Nr. 11, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 22.8.2019; Intervista Nr. 16, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

11 Intervista Nr. 22, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 29.8.2019; Intervista Nr. 16, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019; Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 19, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 20.9.2019.

12 Intervista Nr. 6, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 13.8.2019.

13 Neni 33 i Ligjit Nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton procedurat për depozitimin dhe verifikimin e ankesave.

14 Intervista Nr. 10, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 18.8.2019; Intervista Nr. 4, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 13.8.2019; Intervista Nr. 15, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 27.8.2019; Intervista Nr. 18, Përfaqësues i Medias, 8.9.2019; Intervista Nr. 20, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 23.8.2019; Intervista Nr. 16, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019; Intervista Nr. 19, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 20.9.2019.

15 Shihni <https://www.equalitylaw.eu/downloads/4958-albania-country-report-non-discrimination-2019-pdf-985-kb>

16 Shqipëri, Kodi i Procedurës Administrative, Ligji Nr. 44/2015, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, datë 30.4.2015, hyri në fuqi më 28.5.2016.

17 Intervista Nr. 6, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 13.9.2019; Intervista Nr. 11, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 22.8.2019; Intervista Nr. 5, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 14.8.2019.

18 Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019.

19 Ratifikuar më 2 tetor 1996.

20 Ratifikuar më 27 shkurt 1992.

21 Më datë 14.11.2002, Shqipëria ratifikoi Kartën Sociale Evropiane të rishikuar dhe pranoi 64 nga pikat e rishikuara të Kartës. Ajo nuk e ka nënshkruar

protokollin për ankesat kolektive.

22 Ratifikuar më 11 maj 1994.

23 Ratifikuar më 23 qershor 2003.

24 Ratifikuar më 4 tetor 1991.

25 Ratifikuar më 4 tetor 1991.

26 Ratifikuar më 11 maj 1994.

27 Ratifikuar më 11 maj 1994.

dhe Dënimeve ose Trajtimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese.²⁸ Të gjitha dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën janë përafruar me legjislacionin kombëtar.

Megjithëse kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri është gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, zbatimi i këtyre instrumenteve është i kufizuar dhe realizimi i të drejtave të njeriut mbetet ndjeshëm i pamjaftueshëm. Janë bërë përpjekje për të garantuar që detyrimet që rrjedhin nga të drejtat ndërkombëtare të njeriut të përafrohen me legjislacionin kombëtar. Në prill 2010, Krerët e Misionit të BE-së në Shqipëri miratuan “Strategjinë Kombëtare për Zbatimin e Direktivave të BE-së për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut”.²⁹ Gjithashtu, në vitin 2019, Shqipëria miratoi Deklaratën e OKB-së për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut.³⁰ Megjithatë, Shqipëria nuk e ka ratifikuar ende Protokollin Opsional të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin Opsional të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore.³¹

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke përfshirë të drejtën për të jetuar (Neni 21), lirinë e personit dhe moskufizimit të paligjshëm të saj (Nenet 27-28), lirinë e tubimit (Neni 47), lirinë e organizimit (Neni 46), lirinë e mendimit dhe shprehjes (Nenet 22-23), lirinë e mosdiskriminimit (Neni 18), dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik (Neni 42). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është ligji më lartë i vendit, e cila parashikon se të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë përparësi krahasuar me ligjet kombëtare që mund të mos përputhen me to.³²

LIRIA E ORGANIZIMIT: Kushtetuta parashikon lirinë e organizimit, e cila përgjithësisht zbatohet në praktikë. Megjithëse Ligji Nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" njeh të drejtën e çdo personi fizik ose juridik, qoftë vendas apo i huaj, për të ngritur një organizatë jofitimprurëse ose për të qenë anëtar i saj,³³ procesi i centralizuar i regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është i gjatë, i ndërlikuar dhe i kushtueshëm. Gjithashtu, proceset e tjera, si ndryshimi i përfaqësuesit të zyrës, ndryshimi i adresës së zyrës, ndryshimet në bordin e organizatës, etj., duhet të kalojnë përmes Gjykatës së Tiranës. Nga ana tjetër, kjo është një barrë e panevojshme për gjykatën, e cila duhet të luajë rolin e një zyre regjistrimi. Po ashtu, kjo mund të ketë një efekt shkurajues për organizatat jofitimprurëse, veçanërisht kur bëhet fjalë për një organizatë që vepron në terren me kapacitete të kufizuara. Pengesa e dytë lidhet me detyrimin e OJF-ve për të pasur një punonjës të paguar me kohë të plotë, në mënyrë që të regjistrohen pranë autoriteteve tatimore, sipas dispozitave të parashikuara për kërkesat e regjistrimit tatimor. Kjo kërkesë është një barrë e madhe pasi organizatat e reja jofitimprurëse shpesh nuk janë në gjendje për të paguar një punonjës me kohë të plotë. Së fundi, OJF-të që kryejnë veprimtari ekonomike janë subjekt i të njëjtave kërkesa tatimore si bizneset private. Për rrjedhojë, regjimi tatimor kufizues, i cili rregullon sektorin e organizatave jofitimprurëse, vijon të pengojë zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e këtij sektori.³⁴ Në përgjithësi, Ligji ka një efekt shkurajues mbi MDNJ-të dhe kufizon ushtrimin e lirë dhe të plotë të lirisë së tyre të organizimit.

LIRIA E TUBIMIT: Liria e tubimit rregullohet me Ligjin Nr. 8773, datë 23.4.2001, “Për Tubimet”,³⁵ dhe është kryesisht në përputhje me Udhëzuesin e ODIHR-it për Lirinë e Tubimit Paqësor. Megjithëse respektohet në teori, praktikisht e drejta për tu organizuar në tubime paqësore dhe për të marrë pjesë në to has disa pengesa. Demonstratat e grupeve civile kanë qenë përgjithësisht paqësore, por raportet kanë treguar forma të ndryshme të ndërhyrjes së shtetit në të drejtën për tu organizuar në mënyrë paqësore.³⁶ Në disa raste, autoritetet ose kanë refuzuar ose e kanë shpërndarë tubimin, kanë bërë përpjekje për largimin e protestuesve nga vendi i mbajtjes së tubimit ose i kanë ndaluar apo kanë vendosur sanksione për organizatorët e tubimeve, si në aspektin administrativ edhe në atë penal.³⁷ Megjithëse Ligji garanton mundësinë për tu mbledhur në mënyrë spontane, ka pasur disa raste kur policia ka ndërhyrë kundër protestave spontane, pasi organizatorët e tyre nuk kishin marrë leje për organizimin e tyre. Për më tepër, nuk ka dallim të qartë ndërmjet atij që Ligji i referohet si “njoftim”, kundrejt “kërkesës” apo “lejes”. Ka mospërputhje ndërmjet Ligjit Nr. 8773, datë 23.4.2001, “Për Tubimet”, i cili parashikon vetëm procedura njoftimi, pa leje paraprake dhe, nga ana tjetër, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila përcakton se organizimi ose pjesëmarrja në manifestime të paligjshme përbën kundërvajtje penale. Për rrjedhojë, raportet tregojnë se procedimet penale të filluara ndaj aktivistëve të të drejtave të njeriut, të cilët marrin pjesë në tubime, nuk janë ligjërisht të besueshme dhe lënë vend për interpretim.³⁸ Së fundi, Ligji nuk adreson të drejtën për kundërtubime. Megjithëse kjo e drejtë mbështetet përgjithësisht në praktikë, mangësitë e Ligjit mund të çojnë drejt shtypjes dhe zvogëlimit të hapësirës civile për MDNJ-të.

NDIKIMI I QEVERISË NË VEPRIMTARITË E OJF-VE: Sipas kuadrit aktual ligjor,³⁹ OJF-të ushtrojnë veprimtarinë e tyre të pavarura nga ndikimi dhe interesat e qeverisë. Sipas Nenit 7 të Ligjit Nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”, organet shtetërore nuk ndërhyjnë në veprimtaritë e organizatave jofitimprurëse. Përkundrazi, supozohet që ato t’i mbështesin dhe nxisin veprimtaritë e organizatave jofitimprurëse. Ndalimi ose kufizimi i veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse bëhet vetëm në rastet dhe mënyrën e përcaktuar në ligj. Sipas Nenit 44 të Ligjit Nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar, gjykata mund të vendosë

28 Ratifikuar më 1 tetor 2003.

29 Marrë nga http://eeas.europa.eu/archives/delegations/albania/documents/eu_albania/local_strategy_hrd_sq.pdf

30 Fletorja Zyrtare Nr. 31, datë 13.3.2019, marrë nga <http://qzb.gov.al/eli/rezolute/2019/03/05/368>

31 OKB, ‘Traktatet Shumëpalëshe të Depozituara pranë Sekretarit të Përgjithshëm’, Përmbledhje e Traktatit të Kombeve të Bashkuara.

32 Neni 122, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

33 Ligji Nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar.

34 Marrë nga <https://partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-civil-society-development-country-report-for-albania-2/>

35 Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995, “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, dhe Ligji Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

36 Marrë nga <http://ecnl.org/wp-content/uploads/2017/12/ECNL-FoPA-Albania-2017.pdf>

37 Njësoj si sipërshkruar Partnerët Shqiptarë, 2018.

38 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Shembuj të Rasteve të Trajtuar, lidhur me Rezolutën e Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut.

39 Neni 7 i Ligjit Nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”.

shpërbërjen e organizatës jofitimprurëse me kërkesë të organit shtetëror kompetent në rastet kur: a) veprimtaria e organizatës jofitimprurëse bie ndesh me Kushtetutën; b) OJF-ja kryen veprimtari të paligjshme; c) OJF-ja nuk është themeluar sipas kërkesave të Ligjit; d) OJF-ja ka falimentuar sipas ligjit për falimentimin. Gjithashtu, Neni 25 i Ligjit të sipërpërmendur parashikon mundësinë për korrigjim të vendimit të gjyqtarit që rrëzon kërkesën, duke apeluar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

LIRIA E SHPREHJES: Megjithëse Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes, Ligji i fundit “Antishpifje”, i propozuar nga qeveria, shënon regres në këtë aspekt. Në vitin 2019, qeveria, pa u konsultuar më parë me median, u zotua për të kaluar dy ligje,⁴⁰ të cilat mund të sjellin një nivel të lartë vetëcensurimi në arenën mediatike, duke shkaktuar tashmë kufizime.⁴¹ E ashtuquajtura paketë antishpifje parashikon regjistrimin e detyrueshëm për të gjitha mediat online dhe ngritjen e një organi censure që kontrollon ‘shpifjet’ në median online. Në vend të gjykatës, ndryshimet e propozuara ia kalojnë kompetencat një organi administrativ shtetëror, Autoritetit të Mediave Audiovizive (ndryshe AMA), i cili do të rregullojë përmbajtjen e platformave të medias online. Ajo çfarë e bën këtë situatë mjaft të dyshimtë është fakti se anëtarët e bordit të AMA-s emërohen dhe shkarkohen sipas diskrecionit të partive politike. Mbi të gjitha, një pjese të AMA-s, konkretisht Këshillit të Ankesave, i jepet kompetenca për të hequr përmbajtjen online ose për të vendosur gjoba administrative në rastet e lajmeve të rreme, pothuajse në mënyrë diskrecionare. Në përputhje me ndryshimet e propozuara, së fundmi, qeveria ka bërë përpjekje për të bllokuar stacionet e huaja të lajmeve nëpërmjet AMA-s.⁴² ⁴³ Aktivistët e shoqërisë civile, mediat e pavarura, MDNJ-të dhe disa organizata ndërkombëtare kanë bërë përpjekje për ta bindur qeverinë t’i tërheqë këto projektligje, pasi ato do të shtrëngojnë më tej kontrollin mbi median online, do të pengojnë lirinë e medias dhe do të kufizojnë lirinë e shprehjes.⁴⁴ Pavarësisht këtyre argumenteve, qeveria po bën përpjekje për ta miratuar ligjin, duke pretenduar se “fushata antishpifje” do të disiplinojë median online dhe do të luftojë lajmet e rreme dhe shpifjet.

LIGJET PËR SHPIFJEN⁴⁵: Ligji iu lejon palëve private të depozitojnë padi për shpifje ndaj gazetarëve dhe të përfitojnë kompensim financiar deri në 3 milionë lekë (25,333 euro) për fyerje ose informacione të rreme. Sa për krahasim, paga mesatare mujore në Shqipëri është 51,531 lekë (420 euro),⁴⁶ që do të thotë se gjobat mund jenë të barasvlershme me pagën e 5 viteve. Pra, gazetarët jo vetëm që dënohen për akuza penale, por edhe detyrohen të paguajnë një shumë të madhe parash, dhe që të dyja këto veprime cenojnë lirinë e shprehjes. Legjislacioni shqiptar në fuqi parashikon mbrojtjen nga shpifja dhe mekanizmin e adresimit të shpifjeve në gjykatë. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë për rregullime të reja ligjore posaçërisht për median, pasi nuk është e nevojshme që kompetencat që i takojnë gjykatës t’i atribuohen AMA-s, përderisa AMA është një organ administrativ, anëtarët e të cilit zgjidhen nga Kuvendi.

Pra, siç kuptohet nga analiza e kuadrit ligjor në Shqipëri, disa dispozita ligjore dhe akte ligjore kufizuese që janë prezantuar gjatë disa viteve të shkuara⁴⁷ kanë kufizuar kapacitetet e MDNJ-ve për ushtrimin e plotë të të drejtave të tyre. Tkurrja e hapësirës për lirinë e shprehjes tregon betejat me të cilat përballen MDNJ-të për t’iu dhënë zë shqetësimeve të tyre. Gjithashtu, disa procedura burokratike lidhur me lirinë e organizimit dhe ato që lidhen me lirinë e tubimit mund të shërbejnë si një përpjekje për të kontrolluar ngushtësisht aktivizmin e MDNJ-ve.

Ka disa mekanizma që mbrojnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Ato përfshijnë Institucionin e Avokatit të Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Nënkomisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut.

INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT është institucioni kryesor i pavarur në Shqipëri për promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Ai ka autoritetin të ngrejë padi dhe të fillojë një hetim bazuar në ankesat e palëve të cënuara ose me iniciativën e vet. Megjithatë, institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka të drejtën e ekzekutimit të vendimeve, por vepron si një mekanizëm i monitorimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe jep rekomandime për institucionet shtetërore dhe aktorët, duke përfshirë Kuvendin. Pra, ai është më shumë një institucion reagues sesa proaktiv.⁴⁸

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI (KMD) konsiderohet i vetmi autoritet i pavarur përgjegjës për sigurimin e mbrojtjes efikase nga diskriminimi dhe çdo formë tjetër sjelljeje që nxit diskriminimin. KMD-ja i kërkon gjykatës të nisë procedura ekzekutimi lidhur me gjobat e vendosura nga KMD-ja. Megjithëse rolet e Avokatit të Popullit dhe Komisionerit janë përmirësuar me kalimin e viteve, ata kanë ende mungesë kapacitetesh për një qasje gjithëpërfshirëse dhe të fokusuar në trajtimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Një nga arsytet kryesore për këtë është fakti që vendimet e tyre nuk janë detyruese, pasi ata japin vetëm rekomandime, gjë që e bën të vështirë zbatimin e tyre.

NËNKOMISIONI PËR TË DREJTAT E NJERIUT ushtron veprimtarinë e tij nën varësinë e Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pranë Kuvendit të Shqipërisë. Në mars të vitit 2019, Kuvendi i Shqipërisë kaloi një Rezolutë në mbështetje të veprimtarisë së MDNJ-ve. Megjithatë, në përgjithësi, ka pak dijeni për këtë rezolutë dhe kapacitetet e saj zbatuese.⁴⁹

40 Ligji Nr. 9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

41 Marrë nga <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2019/albania>

42 Procedura e emërimit për anëtarët e AMA-s dhe veprimtaria e saj ndikohen nga situata politike. Shihni <http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/Albanian%20Media%20Scene%20vs%20European%20Standards.pdf>

43 Paketa anti-shpifje është kritikuar shumë për shkak të gjobave të ashpra (deri në pezullimin e veprimtarisë) që ajo vendos për mediat që nuk ndjekin rregullat. Për më tepër, mediat duhet të paguajnë gjobat para se të shterohet shqyrtimi ligjor.

44 Deklaratë për paketën ligjore të projektligjeve, e miratuar nga Këshilli i Ministrave për rregullimin e medias online.

45 Neni 120 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, pika 2, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8733, datë 24.1.2001.

46 Marrë nga <http://www.instat.gov.al/en/themes/labour-market-and-education/wages/publications/2019/wage-statistics-q1-2019/>

47 Siç është “Ligji Antishpifje”.

48 Intervista Nr. 12, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 9.9.2019; Intervista Nr. 7, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 14.8.2019; Intervista Nr. 20, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 23.8.2019.

49 Marrë nga <https://www.parlament.al/Files/Procesverbale/20190704140414Procesverbal,%20dat%C3%AB%2013.05.2019.pdf>; Intervista Nr. 20,

4. TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE TË MBROJTËSVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Megjithëse puna e MDNJ-ve nuk kufizohet haptazi nga autoritetet shtetërore, mbi të ushtrohet presion i madh në mënyrë sporadike dhe të tërthortë. Ky presion është mjaft i dukshëm lidhur me lirinë e tubimit. Ligji dhe Kushtetuta ndalon arrestimin dhe paraburgimin në mënyrë arbitrare, dhe qeveria e ka mbështetur në përgjithësi të drejtën për tubim paqësor. Procedurat e njoftimit nëse zhvillimi i një protestë është i pranueshëm apo jo janë mjaft të paqarta dhe të dykuptimta. Meqenëse ligji nuk parashikon protesta spontane, shpesh lejet nuk jepen si një taktikë frike për të ushtruar presion dhe për të frenuar aktivistët.⁵⁰ Ka disa raste kur protestuesit dhe organizatorët shoqërohen dhe merren në pyetje në ambientet e paraburgimit të policisë. Prandaj, paqartësia ligjore dhe defektet ligjore për zhvillimin e një tubimi të paautorizuar mund të shfrytëzohet për të ndaluar ose kriminalizuar mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Protesta e ndaluar e aktivistëve kundër brutalitetit policor të pretenduar, i cili rezultoi në vdekjen e një të riu rom në qelinë e paraburgimit të komisariatit të policisë në Korçë

Më datë 15 maj 2019, një i ri rom humbi jetën gjatë qëndrimit në qelinë e paraburgimit në komisariatin e policisë në Korçë. Familja e tij ngriti akuzën se ai vdiq për shkak të keqtrajtimit dhe abuzimit nga policia, duke pretenduar se kishin fotografi që provonin ushtrimin e dhunës në trupin e tij. Më vonë, Prokuroria e Korçës deklaroi se policia nuk kishte ushtruar dhunë, duke pretenduar se i riu vdiq për shkak të një sëmundjeje të mushkërive. Prokurorët ngritën akuza ndaj tre punonjësve të policisë, duke pretenduar se ata nuk kishin dhënë ndihmën e parë, gjë që solli vdekjen e të riut.⁵¹ Institucioni i Avokatit të Popullit arriti në përfundimin se nuk kishte prova të mjaftueshme për të provuar pretendimet ose për të ngritur akuza.⁵² Aktivistët e OJF-ve organizuan një protestë përballë Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku iu kërkuan autoriteteve përkatëse ta hetonin rastin dhe t’i jepnin fund pandëshkueshmërisë.⁵³ Në momentin e fundit, autoritetet e policisë shqiptare refuzuan të jepnin leje për zhvillimin e protestës, kështu që aktivistëve iu desh ta organizonin atë si një konferencë urgjente për shtyp dhe jo si një protestë. Ka pretendime se disa aktivistë u shoqëruan në rajonin e policisë dhe u morën në pyetje, pasi u akuzuan për pjesëmarrje në demonstrata të paligjshme.⁵⁴

Disa aktivistë kanë raportuar se policia ka filluar procedime penale ndaj protestuesve për shkak të ‘organizimit dhe pjesëmarrjes në grumbullime e manifestime të paligjshme,⁵⁵ që konsiderohet vepër penale.⁵⁶ Ky lloj intimidimi shton presionin psikologjik mbi aktivistët. Ky shqetësim u shpreh edhe nga i intervistuari i mëposhtëm:

Problemi kryesor me të cilin unë përballem lidhur me tubimet është burokracia e tepërt kur kërkohet leje për zhvillimin e një proteste. Kjo është një situatë shumë e ndërlikuar, pasi burokracitë e shumta nënkuptojnë vonesën e protestës. Kjo bën që protesta të zhvillohet në një moment kur çështja nuk është më aq e mprehtë, çka zbeh efikasitetin e demonstratës. Ndonjëherë, si një MDNJ, ju keni vullnetin për t’ju bashkuar kauzës, por më pas zbuloni se policia nuk iu ka dhënë leje organizatorëve, kështu që e gjeni veten në ambientet e paraburgimit në polici duke u marrë në pyetje nga zyrtarët e policisë. (Intervista Nr. 12, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 9.9.2019)

Shumë MDNJ u shprehën se besojnë që protestat janë një mjet efikas advokimi për kauzën e tyre. Ata supozojnë se për shkak të hetimit, protestat kanë më shumë gjasa që ta izolojnë çështjen dhe ta përqesojnë situatën sesa të sjellin një kontribut pozitiv.⁵⁷ Madje, edhe nëse protestat mund të sjellin një kontribut pozitiv, aktivistët nuk vendosin që të organizojnë një protestë për arsye se janë të frikësuar, iu mungojnë burimet financiare ose ndihen të kërcënuar nëse protestojnë kundër politikave qeveritare.⁵⁸

Ligji për të Drejtën e Informimit nuk zbatohet si duhet, pasi MDNJ-të e kanë jashtëzakonisht të vështirë për të pasur akses në informacion, veçanërisht në të dhënat lidhur me çështje të ndjeshme të të drejtave të njeriut nga institucionet publike.⁵⁹ Burokracitë e tepërta dhe mungesa e transparencës janë gjerësisht të pranishme, veçanërisht nga autoritetet vendore.⁶⁰ Prandaj, disa MDNJ ose kanë përdorur rrjetin e tyre social për të marrë informacion përmes kanaleve jozyrtare,⁶¹ ose iu janë drejtuar gjykatës në rastet kur akses i informacion iu është mohuar, pavarësisht kërkesave të shumta.⁶²

Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 23.8.2019.

50 Intervista Nr. 21, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 10.9.2019; Intervista Nr. 3, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 27.8.2019; Intervista Nr. 11, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 22.8.2019.

51 Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Raport për Situatën mbi Respektimin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Shqipëri për vitin 2018.

52 Njësoj si sipërshkruar.

53 Marrë nga <https://opinion.al/protesta-per-vdekjen-e-enea-ftoit-xhafa-te-jape-sqarime-duam-drejtjes/>

54 Marrë nga <http://www.tiranatimes.com/?p=137212>; Intervista Nr. 4, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 13.8.2019.

55 Intervista Nr. 3, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 27.8.2019.

56 Neni 262 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë përcakton se organizimi i grumbullimeve të personave në sheshe dhe vende të kalimit publik, pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta apo kur nga organizatorët shkelen kushtet e parashtuara në kërkesën për leje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

57 Intervista Nr. 4, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 13.8.2019.

58 Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 11, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 22.8.2019; Intervista Nr. 5, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 14.8.2019.

59 Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 14, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019. Për shembull, mungesa e të dhënave nga autoritetet publike lidhur me rastin e të riut rom, i cili humbi jetën gjatë qëndrimit në qelinë e paraburgimit në komisariatin e policisë në Korçë (rasti nr. 1) ose në rastin e një MDNJ-je nga media, mungesa e të dhënave gjatë hetimit të krimin ose korrupsionit nga ana e zyrtarëve shtetërorë/politikë.

60 Intervista Nr. 15, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 27.8.2019; Intervista Nr. 12, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 9.9.2019; Intervista Nr. 14, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 21, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 10.9.2019.

61 Intervista Nr. 7, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 14.8.2019; Intervista Nr. 12, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 9.9.2019; Intervista Nr. 1, Përfaqësues i Medias, 12.8.2019.

62 Intervista Nr. 5, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 14.8.2019.

Mbështetja dhe bashkëpunimi i qeverisë lidhur me MDNJ-të varet nga fakti nëse ata i kritikojnë shpesh politikën e qeverisë. Zyrtarët publikë nuk janë të gatshëm që të pranojnë një nivel të lartë të kritikave publike dhe hetim nga MDNJ-të, kështu që pengesat me të cilat përballen këta të fundit kur zhvillojnë veprimtaritë e tyre janë sinjale të rëndësishme të dërguara nga zyrtarët për të balancuar nivelin e tyre të kritikës.⁶³ Zakonisht, presioni nuk vjen drejtpërdrejt nga autoritetet, por kanalizohet përmes përfaqësuesve të tyre, të cilët mund të jenë aktivistë politikë.⁶⁴ Nga ana tjetër, nëse MDNJ-të janë pro qeverisë dhe në favor të politikave dhe interesave të tyre, autoritetet publike janë mjaft mbështetëse për punën e tyre.⁶⁵ Sfidat me të cilat përballen MDNJ-të që kritikojnë qeverinë ndryshojnë në varësi të punës së tyre. Format e kufizimeve janë mjaft të larmishme. MDNJ-të nga shoqëria civile kanë më shumë gjasa të përballen me kufizimet e mëposhtme në punën e tyre të përditshme:

- **Kooptimi nëpërmjet ofrimit të alternativave për bashkëpunim** për aktivistët e dalluar ose përgjegjësit kryesorë të komunitetit, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë tek ata. Megjithatë në pamje të parë kjo mund të duket një mënyrë e zgjuar për të kontrolluar qarkullimin e informacionit, ajo është në fakt një masë efikase zbutëse që synon t'i heshtë ata që ngrenë zërin. Ky lloj presioni përdoret shpesh nga autoritetet publike si një përpjekje për të nxitur 'tërheqjen e protestuesve nga kauza e tyre', për shembull kur shoqëritë private të lidhura me zyrtarët qeveritarë dëshirojnë të ulin numrin e kundërshtimeve ndaj investimeve të tyre.⁶⁶
- **Fushata përbaltjeje nga zyrtarët qeveritarë** dhe platformat mediatike për të cenuar legjitimitetin e punës së MDNJ-ve dhe për të shmangur vëmendjen nga çështjet e ngritura nga shoqëria civile. Shpesh, qeveria qendrore dhe vendore supozojnë se organizatat e shoqërisë civile janë themeluar me qëllim përfitimin e fondeve të disponueshme.⁶⁷ Prandaj, elita politike ka përdorur gjuhë denigruese dhe fyese që i etiketon MDNJ-të si hajdutë të politizuar, agresorë, njerëz të ulët pa integritet, ose pa kapacitet intelektual për të kuptuar rezultatet pozitive afatgjata të nismave qeveritare. Gjuha fyese dhe denigruese ndaj gazetarëve, si etiketimi i tyre si "kazan", përdoret në të njëjtën mënyrë në raste të tjera nga ana e zyrtarëve të nivelit të lartë. Këto lloj ngjyrimesh negative, të cilat zakonisht janë më të shpeshta në rastet e lajmeve të bujshme, për shembull kur ndodh një skandal, pasqyrojnë një retorikë gjithnjë e në rritje kundër medias. Kjo është formë presioni që përdoret për t'i lënë në hije pretendimet e mbrojtësve, për të cenuar reputacionin e tyre publik, si dhe për të ulur motivimin e MDNJ-ve dhe për t'i frenuar ata që të vijojnë aktivizmin e tyre.⁶⁸
- **Presioni nga donatorët për shkurtimin e fondeve ose ndërprerjen e bashkëpunimit.** Disa organizata donatore kanë lidhje të drejtpërdrejta me qeverinë, gjë që ka rezultuar në kërcënime që një projekt t'i nënshtrohet një sërë kufizimesh, duke përfshirë shkurtimin e fondeve, nëse ai identifikon një defekt në veprimtaritë e qeverisë. Ky presion vjen shpesh si rezultat i intimidimit (si ndërprerja e bashkëpunimit me institucionet publike) që iu bëhet donatorëve nga qeveria.⁶⁹

Gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut janë në një rrezik të madh, për shkak të gjinisë së tyre dhe ndjeshmërisë së çështjeve me të cilat ata punojnë.⁷⁰ Rasti i mëposhtëm përshkruan disa nga sfidat kryesore me të cilat përballen ato:

Telefonata kërcënuese për jetën dhe akuza shpifëse ndaj grave mbrojtëse të të drejtave të njeriut

Më 8 mars 2019, aktivistët e shoqërisë civile organizuan një demonstratë për të thyer heshtjen ndaj niveleve të paprecedenta të dhunës ndaj grave në Shqipëri. Aktivistët e OJF-ve i kërkuar qeverisë të marrë masa të menjëhershme ndaj dhunës me bazë gjinore. Të veshur të gjithë me të zeza, protestuesit u ulën për të simbolizuar reagimin pasiv shoqëror dhe institucional ndaj fenomenit, dhe në solidaritet me gratë që humbën jetën për shkak të dhunës me bazë gjinore.⁷¹ Megjithatë u konsiderua një protestë paqësore, pa kërcënim të veçantë ndaj sigurisë së protestuesve, ka akuza se aktivistët e OJF-ve, që morën pjesë në protestë, kishin marrë kërcënime verbale nga zyrtarët publikë. Kërcënimet varionin nga shkurtimi i fondeve të ndërprerja e bashkëpunimit në të ardhmen, nëse aktivistët nuk e ndërprisnin protestën.⁷² Gjithashtu, aktivistët që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut kanë më shumë gjasa të jenë subjekt i mesazheve kërcënuese për jetën nga autorët e dhunës.⁷³ Drejtoresha e strehës së grave, B.P., pranon se ajo ka marrë telefonata kërcënuese në adresë të saj nga persona anonimë. Ajo raportoi se ka marrë kërcënime me vdekje nga partneri abuziv i një prej viktimave që ajo ka asistuar, i cili është një biznesmen i njohur në lagjen e saj. Ajo ka qenë shënjestër e një fushate përbaltjeje në media, sipas së cilës ajo etiketohej si tutore që rrëmben fëmijët e viktimave që ajo ndihmon, dhe se ka shitur gruan e biznesmenit. Po ashtu, në artikull pretendohet se ajo kishte urdhëruar vrasjen e fëmijëve dhe se organizata e saj cilësohej si një shtëpi publike e maskuar.⁷⁴ Ajo nuk bëri asnjë përpjekje të mëtejshme për ta raportuar rastin pranë autoriteteve përkatëse, duke qenë se ishte e frikësuar për faktin se vëmendja e mëtejshme mediatike lidhur me rastin do të rrezikonte jetët e viktimave.

63 Intervista Nr. 9, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 18.9.2019; Intervista Nr. 7, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 14.8.2019.

64 Intervista Nr. 18, Përfaqësues i Medias, 8.9.2019.

65 Intervista Nr. 9, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 18.9.2019; Intervista Nr. 16, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

66 Intervista Nr. 11, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 22.8.2019.

67 Intervista Nr. 14, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 12, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 9.9.2019; Intervista Nr. 6, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 13.8.2019.

68 Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019; Intervista Nr. 11, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 22.8.2019.

69 Intervista Nr. 09, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 18.8.2019; Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 3, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 27.8.2019; Intervista Nr. 9, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 18.9.2019; Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019; Intervista Nr. 6, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 13.8.2019.

70 Intervista Nr. 14, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

71 Marrë nga <http://thebalkanista.com/2019/03/04/protestors-in-black-set-to-demonstrate-%E2%80%8B8Bon-international-womens-day-in-tirana/>

72 Intervista Nr. 13 me mbrojtësin e të drejtave të njeriut, 26 gusht 2019; Intervista Nr. 9, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 18.9.2019.

73 Intervista Nr. 14 me mbrojtësin e të drejtave të njeriut, 26 gusht 2019.

74 Marrë nga <https://kvinatitllkvinna.org/wp-content/uploads/2018/10/10-Femdefenders-the-hatred-against-women-ENG.pdf>

MDNJ-të raportojnë raste kur individët e punësuar nga autoritetet publike janë përpjekur të infiltrohen në protesta ose manifestime me qëllim krijimin e një përçarjeje brenda grupit, ose për të ndikuar te grupi apo te fokusi i protestës për t'i moderuar kërkesat e tyre. Në disa raste, përpjekjet e tyre synojnë politizimin e protestës ose manipulimin e imazhit publik të veprimtarisë.⁷⁵ Për shembull, deklarohet se janë bërë përpjekje për të nxitur dhunë me qëllim përshkallëzimin e protestës dhe krijimin e një imazhi të një grupi të dhunshëm. Këta individë janë bërë më pas ndërmjetës ose figura drejtuese që përpiqen të administrojnë protestën, të shmangin tensionin, ose të devijojnë apo legjitimojnë protestën duke përdorur argumente të ndryshme.⁷⁶

MDNJ-të raportojnë se ka mijëra tallje në internet që përdoren për të përbaltur punën e MDNJ-ve duke komentuar në postimet në median sociale. MDNJ-të janë një shënjestër shumë e arritshme pasi ata janë shpesh individë të rëndësishëm në arenën mediatike dhe nuk kanë frikë që zëri i tyre të dëgjohet. Është e qartë që talljet kanë një "axhendë" dhe bëhen me shumë gjasë nga militantë të partive politike ose të paguar prej tyre, siç mund të shihet në shembullin e mëposhtëm.⁷⁷

Në një rast, forumi rinor i një partie në Shqipëri mobilizoi anëtarët e vet për të komentuar fraza ekzakte në postime me natyrë politike. Rreth 6 mesazhe u shpërndanë për afërsisht 300 persona, duke përmbytur median sociale në mënyrë strategjike me qëllimin e vetëm, atë të keqorientimit të opinionit publik dhe krijimin e skepticizmit tek njerëzit mbi besueshmërinë e shkrimit.⁷⁸

Aktivistët për mjedisin raportojnë se kanë përjetuar forma të ndryshme sulmesh nga autoritetet shtetërore, bizneset dhe persona të tjerë anonimë.

Beteja kundër ndërtimit të e hidrocentralit në Parkun Kombëtar të Valbonës

Konsorciumi i OJF-ve kombëtare "Të mbrojmë lumenjtë", organizatat ndërkombëtare, shkencëtarët dhe akademikët, si dhe banorët vendas kanë organizuar një sërë protestash kundër ndërtimit të hidrocentraleve (HEC-eve). Deri më tani, pretendohet se janë anuluar 9 HEC-e të Shoqërisë "Valbona Energy", ndërsa do të vijojë ndërtimi i tre HEC-ve të tjera. Aktivistët e shoqërisë civile e kundërshtuan projektin për shkak se ata parashikonin një ndikim negativ në mjedisin e parkut kombëtar, peizazhin e tij në tërësi, turizmin dhe në rrjedhën natyrore të lumit.⁷⁹ Së pari, aktivistët i kërkuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit bërjen publike të lejeve dhe dokumenteve të projektit për HEC-in e Valbonës, pasi ata dyshonin se nuk ekzistonte dokumentacioni i duhur ose se ishin kryer shkelje për të lehtësuar miratimin e HEC-it. Në fakt, Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk i vuri në dispozicion dokumentet.⁸⁰ Konsultimi publik është një tjetër 'temë e nxehtë' e debatit mbi vlefshmërinë e dokumentacionit të paraqitur nga koncesionarët, pasi shumë banorë pretendojnë se shoqëria ka falsifikuar firmat e tyre për miratimin e projektit (duke përfshirë firmat e personave të vdekur) dhe se procesi i konsultimit publik me komunitetet vendore ka qenë i pamjaftueshëm dhe joefikas. Gjatë këtyre protestave, policia arrestoi dy aktivistë.⁸¹ Më vonë, aktivistët nuk u lejuan të bënin fotografi dhe video pranë zonës së ndërtimit.⁸² Gjithashtu, aktivistët e OJF-ve pretendojnë se autoritetet vendore i etiketuan ata si persona 'anti-zhvillimit' ose 'antishqiptarë'. Aktivistët dhe pjesëtarët e komunitetit që kundërshtuan HEC-et raportuan raste të ngacmimit të pretenduar si nga autoritetet shtetërore vendore, ashtu edhe nga aktorët e shoqërisë, si: arrestime ose kërcënime për arrestime, kërcënime për pushim nga puna, ndjekje penale selektive e aktivistëve, paditje në gjykatë,⁸³ kërcënime anonime dhe fushata përbaltjeje që cenojnë marrëdhëniet familjare dhe shoqërore,⁸⁴ inspektime të shpeshta financiare dhe ndjekje penale.⁸⁵ Beteja për anulimin e lejeve për 3 HEC-et e mbetura vijon ende. Megjithatë, mungesa e gjykatave funksionale i ka kompromentuar betejat e tyre ligjore. Ata kanë depozituar dokumente për disa çështje paralele në gjykatat administrative, civile dhe penale, pasi shumë prej çështjeve mund të përfundojnë të bllokuara në gjykatat e larta shqiptare (jofunksionale).

Ka pasur edhe disa raste kur qeveria, bizneset private dhe rrjetet e krimit të organizuar kanë bashkëpunuar për të ushtruar presion mbi median, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë, dhe kanë censuruar artikuj investigativë që raportojnë krimin dhe/ose korrupsionin.⁸⁶ Mbi të gjitha, pavarësia e medias shqiptare është shpesh e kompromentuar nga interesat politike ose ekonomike të pronarëve të medias. Prandaj, vetëcensurimi është përhapur gjerësisht ndërmjet gazetarëve si një mënyrë për të shmangur kërcënimet, fushatat e përbaltjes ose sulmet. Në përgjithësi, ekziston një "kulturë kopjimi" sipas së cilës platformat e lajmeve kopjojnë raportimin e njëra-tjetrës. Por, kur një temë është shumë e ndjeshme ose kritike, lajmet e reja mund të shpërfillen krejtësisht. Kjo ndodh veçanërisht me publikimet që trajtojnë të drejtat e njeriut.⁸⁷ Shpesh, politikanët e nivelit të lartë deklarojnë publikisht të dhëna dhe fakte të ndryshme menjëherë pasi janë kritikuar politikën e tyre. Këto fakte të ndryshme transmetohen në media politikisht të njëanshme, raportimi i të cilave ndikohet shumë nga interesat politike dhe

75 Intervista Nr. 14, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

76 Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019.

77 Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019; Intervista Nr. 3, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 27.8.2019; Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019; Intervista Nr. 16, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

78 Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019.

79 Marrë nga http://www.ecoalbania.org/wp-content/uploads/2017/04/Water_conflict_study-2017-1.pdf

80 Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019.

81 Marrë nga <https://www.reporter.al/lufta-per-zemren-blu-te-alpeve-shqiptare/>

82 Intervista me aktivistin e OJF-ve për çështje mjedisore.

83 Termi kuptohet si zbatim i procedimeve ligjore dhe administrative të pajustificuara ose i çdo forme të keqpërdorimit të kompetencës administrative dhe juridike, duke përfshirë zbatimin arbitrar dhe abuziv të legjislacionit, me qëllimin ose efektin e pengimit ose stigmatizimit të punës së të drejtave të njeriut. Marrë nga <https://www.osce.org/odihr/guidelines-on-the-protection-of-human-rights-defenders?download=true>.

84 Marrë nga https://www.americanbar.org/groups/human_rights/reports/communities-under-pressure-albania-june-2019/

85 Marrë nga <https://citizens-channel.com/2019/06/20/ndertimi-i-hec-eve-ne-valbone-banoret-e-tropojes-nen-kercenime-te-vazhdueshme/>

86 Intervista Nr. 1, Përfaqësues i Medias, 12.8.2019; Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019.

87 Intervista Nr. 3, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 27.8.2019; Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

ekonomike të pronarëve të tyre. Kjo kulturë mbizotëruese e propagandës e bën Shqipërinë të cenueshme lidhur me çështjen e keqinformimit dhe përhapjes së lajmeve të rreme.⁸⁸ Një nga të intervistuarit pretendonte se:

Mjedisi mediatik në Shqipëri është shumë i njëanshëm dhe kjo përbën një problem real pasi mediat shpërfillin, transformojnë ose përsëritin argumentet tuaja kur nuk ka një nevojë reale për të bërë diçka të tillë. Për shembull, tre ditë pasi organizata jonë publikoi një artikull për efektet negative të incineratorëve, platforma mediatike personale e Kryeministrit transmetoi një mbledhje ndërmjet ministrave ku u diskutuan efektet pozitive të këtyre impianteve. Me pak fjalë, ata nuk po na quajnë gënjeshtarë, por po përpiqen të mbërthejnë opinionin publik dhe ta riformësojnë atë sipas interesave të tyre. Kjo na vë përpara një taktike tjetër që përdoret nga politikanët, e cila përdor fakte të ndryshme menjëherë pasi disa raporte denoncojnë politikat e tyre. (Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019)

MDNJ-të raportojnë për disa pengesa në aksesin ndaj autoriteteve publike. Është bërë pothuajse e pamundur që gazetarët kontaktojnë me politikanë të nivelit të lartë pa pasur lidhje të afërta me elitën politike. Të intervistuarit përmendin shumë raste kur autoritetet e përgatisin vetë raportimin për mediat. Për shembull, një ekip personal i marrëdhënieve me publikun (PR) shpërndan një raport televiziv të plotë ose dorëzon një artikull të përfunduar që përmban vetëm një deklaratë PR. Kjo e bën të vështirë raportimin e drejtpërdrejtë ose përpilimin e një artikulli të balancuar. Duke pasur parasysh se shumica e lajmeve vijnë të përgatitura paraprakisht, konferencat për shtyp janë bërë gjithnjë e më të pakta.⁸⁹

Aspektet gjinore të të drejtave civile dhe politike të MDNJ-ve

Të intervistuarit theksuan faktin se GMDNJ-të janë më të rrezikuara për të qenë shënjestër e dhunës me bazë gjinore, siç është ngacmimi seksual dhe gjuha e urrejtjes seksiste.⁹⁰ Megjithëse GMDNJ-të kanë qenë në përgjithësi subjekt i të gjitha formave të presionit dhe intimidimit, ato që punojnë me çështjet e trafikimit, dhunës me bazë gjinore dhe të drejtat e punonjësve të seksit dhe të personave LGBTI+ janë më të rrezikuarat.

Për shumicën e GMDNJ-ve, kërcënimet vijnë kryesisht nga persona anonimë, duke përdorur ose platformat e rrjetit social ose linjat telefonike. GMDNJ-të kanë qenë subjekt i fushatave të përbaltjes që shënjestrojnë punën e tyre dhe organizatat ku ato punojnë. Një nga të intervistuarat u shpreh se pasi kishte mbajtur një konferencë për shtyp mbi dhunën me bazë gjinore, të nesërmen ajo mori menjëherë një mori mesazhesh diskriminuese që vinin në dyshim profesionalizmin e saj dhe madje më shqetësues është fakti që përmbanin gjuhë dhe komente fyese ndaj paraqitjes së saj fizike dhe veshjes.⁹¹ Në raste të tjera, GMDNJ-të raportojnë se autoritetet e qeverisë qendrore janë përpjekur ta heshtin aktivizmin e tyre duke i etiketuar si ‘armiç’, dhe duke i kërcënuar se do ta ndërprisnin bashkëpunimin dhe do të vendosnin kufizime të tjera që do të limitonin aksesin e tyre në financime dhe rrjete donatorësh.⁹²

Shumica dërrmuese e të intervistuarave konstatojnë se GMDNJ-të që punojnë në media kanë më shumë gjasa të përjetojnë ngacmim online sesa kolegët e tyre meshkuj.⁹³ Me publikimin e një artikulli për një temë specifike të ndjeshme, ato bëhen subjekt i intimidimit online, komenteve fyese dhe gjuhës seksiste denigruese. Për shembull, kjo përfshin sulme për të prishur reputacionin e mirë dhe për të diskredituar punën e tyre.⁹⁴ Një tjetër GMDNJ ndan rastin e një prej kolegeve të saj, e cila ka qenë shënjestër e një fushate denigruese përbaltjeje nga një tjetër media. Ky ishte rasti i Alice Taylor-it, një gazetares britanike që jeton në Shqipëri, e cila po raportonte për manipulimin e votave, dhunën në protesta dhe lidhjet e qeverisë me krimin e organizuar dhe pastrimin e parave. Ajo u sulmua nga media proqeveritare (rreth pesë portale online), të cilat e akuzonin se ishte spiune ruse. Për më tepër, ajo ka marrë edhe kërcënime seksuale online nga individë anonimë.⁹⁵

Klima për GMDNJ-të po rëndohet më tej nga mendësia patriarkale dhe stereotipat gjinorë të rrënjësor, që formësojnë perceptimet e publikut mbi rolet gjinore,⁹⁶ të cilat mesa duket po vazhdojnë të shkaktojnë forma të ndryshme intimidimi dhe armiqësie ndaj GMDNJ-ve. Megjithatë, mesa duket, kontributi aktiv i GMDNJ-ve në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut i sfidon këto norma gjinore tradicionale, të cilat janë të rrënjësura në idenë se roli kryesor i grave duhet të kufizohet në sferën private dhe familjare.

GMDNJ-të raportojnë se janë përballur me diskriminime të shumta, për shkak të gjinisë dhe statusit të tyre personal të veçantë, pra aktivizmit të tyre. Për rrjedhojë, ato ndodhen në një pozitë më të pafavorizuar krahasuar me MDNJ-të në përgjithësi.⁹⁷ Siç edhe kuptohet nga ky raport, nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore për të ushtruar kontrollin e duhur lidhur me parandalimin, ndëshkimin dhe zhdëmtimin për sulmet me bazë gjinore. Prandaj, në mungesë të masave të duhura të mbrojtjes, ndonjëherë GMDNJ-të zgjedhin ta mbajnë situatën “nën kontroll”, në vend që të “thyejnë heshtjen” dhe të vendosin në rrezik jetët e tyre dhe të personave të tjerë.

88 Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019.

89 Intervista Nr. 1, Përfaqësues i Medias, 12.8.2019.

90 Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019; Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019; Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019.

91 Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

92 Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019.

93 Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019; Intervista Nr. 1, Përfaqësues i Medias, 12.8.2019.

94 Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019; Për shembull, Desada Metaj, një gazetares me përvojë ka qenë subjekt i talljes dhe intimidimit online për mbi një vit pas raportimit të një rasti të trafikimit të drogës. Shihni <https://mappingmediafreedom.org/index.php/country-profiles/albania/> 95 .

95 Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019.

96 Kjo pasqyron hierarkinë tradicionale gjinore në shoqërinë shqiptare ku gratë supozohet të luajnë rolin e shtëpiakes dhe kujdestares, ndërsa burrat supozohet të jenë kryefamiljarët dhe ata që sigurojnë të ardhurat.

97 Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

5. SULMET, NGACMIMET DHE KUFIZIMET E MBROJTËSVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Megjithëse ka pasur disa raste të raportuara të incidenteve me mbrojtësit e të drejtave të njeriut, studimi konstaton se mjedisi ku ata ushtrojnë veprimtaritë e tyre pengohet nga disa mangësi ligjore dhe institucionale. Shumë të intervistuar kanë theksuar rëndësinë e mekanizmit mbrojtës në nivel kombëtar, i cili do të hetonte shkeljet dhe kufizimet e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, ndryshe nga si ato hetohen aktualisht.⁹⁸ Të tjerët kanë konstatuar se situata e MDNJ-ve do të përmirësohej ndjeshëm nëse do të zbatoheshin dhe respektoheshin plotësisht rregulloret ekzistuese. Situata është mjaft e mprehtë për aktivistët që punojnë për çështjet e LGBTI+.⁹⁹ Komuniteti dhe aktivistët e LGBTI+ vijnë në përballen me forma të rënda të diskriminimit dhe shkelje të të drejtave të njeriut, duke përfshirë sulmet fizike dhe verbale nga publiku dhe autoritetet.¹⁰⁰ Meqenëse institucionet kombëtare nuk kanë vullnet të ndërmarrin veprime, shpesh janë organet ndërkombëtare ato që adresojnë shqetësimet e tyre.¹⁰¹ Diskriminimi ndaj aktivistëve të LGBTI+ është shumë i përhapur.

Aktivisti i LGBTI+ është detyruar të largohet nga Shqipëria pasi ka marrë një mori kërcënimesh me vdekje– gjuha e urrejtjes homofobike

Aktivistët që punojnë në fushën e të drejtave të komunitetit LGBTI+ kanë më shumë gjasa që të jenë subjekt i kërcënimeve për dhunë fizike, sulmeve dhe kërcënimeve me vdekje sesa MDNJ-të e tjerë. Në fakt, është mjaft e zakonshme që aktivistët e LGBTI+ të përballen me forma të ndryshme të diskriminimit të maskuar nga ana e autoriteteve publike. Për shembull, Ministria e Arsimit nuk i ka lejuar aktivistët e LGBTI+ të zhvillojnë veprimtaritë e tyre ndërgjegjësuere në shkolla, pavarësisht faktit se veprimtari të tilla janë parashikuar në Planin Kombëtar të Veprimit kundër Diskriminimit të Komunitetit LGBT.¹⁰² Mesa duket, komuniteti LGBTI+ është komuniteti më i persekutuar nga komentet e përdoruesve¹⁰³ në median sociale. Një deklaratë e bërë nga një aktivist i LGBTI+ në Paradën e katërt të Homoseksualëve në Tiranë kundër homofobisë (18 maj 2019), shkaktoi një valë komentesh urrejtëse, fyerje, sharje dhe kërcënime kundër komunitetit LGBTI+.¹⁰⁴ Zyra e një OJF-je LGBTI+ është sulmuar disa herë nga agresorë të paidentifikuar.¹⁰⁵ Kristi Pinderi, një aktivist dhe themelues i një organizate LGBTI+, ka deklaruar se është detyruar të largohet nga Shqipëria pasi kishte marrë një mori kërcënimesh me vdekje, duke përfshirë kërcënime në rrjete sociale për ta varur, për ta djegur me acid, për t'i shkatërruar makinën dhe mesazhe të tjera denigruese.¹⁰⁶ Aktivistët pretendojnë se është mjaft e vështirë për ta që të sigurojnë prova për diskriminimin, përveçse nëse ato janë me shkrim ose bëhen nga autoritetet publike.¹⁰⁷

Një shqetësim i përhapur gjerësisht ndërmjet shumë aktivistëve është se qeveria nuk është në gjendje të reagojë në kohë dhe t'i vendosë autorët e veprave penale përpara drejtësisë.¹⁰⁸ Nëse autoritetet kanë dijeni për kryerjen e një shkeljeje ose abuzimi të të drejtave të njeriut ndaj një MDNJ-je, procedurat investigative që ndiqen janë të njëjtat si në rastin e çdo autori që do të kishte kryer një vepër penale.¹⁰⁹ Megjithatë, MDNJ-të janë më të rrezikuara krahasuar me grupet e tjera, pasi kërcënimet që ata marrin lidhen me statusin e tyre si mbrojtës të të drejtave të njeriut. Në Kodin Penal nuk parashikohet asnjë dispozitë për veprat e kryera për shkak të ushtrimit të profesionit, si të qenit gazetar apo MDNJ. Gjithashtu, gjatë hetimeve të shkeljeve të kryera ndaj MDNJ-ve ose gazetarëve investigativë nuk ka referenca specifike nëse ato janë femra ose vetidentifikohen si LGBTI+.¹¹⁰ Kjo është mjaft e rrezikshme, duke qenë se autorët nuk ndëshkohen dhe MDNJ-të rrezikojnë jetët e tyre.

Sulm me armë në banesën e gazetares investigative Klodiana Lala

Më 30 gusht 2018, persona të paidentifikuar kanë qëlluar disa herë me armë zjarri automatik në drejtim të banesës së prindërve të gazetares investigative Klodiana Lala, duke dëmtuar disa mure dhe dritare. Në momentin kur ndodhi ngjarja, dy vajzat e saj ishin në gjumë. Ndonëse askush nuk u lëndua, familja ishte shumë e stresuar. Lala ka raportuar mbi krimin e organizuar dhe lidhjet ndërmjet politikës dhe korrupsionit për më shumë se një dekadë. Ajo dyshon se sulmi lidhet me punën e saj si gazetares investigative, duke qenë se as ajo dhe as familja e saj nuk kanë pasur asnjë konflikt më parë. Autoritetet vendore po hetojnë motivin e sulmit, por thuajse një vit më vonë nuk ka ende asnjë person të identifikuar apo të arrestuar. Sulmi u dënua nga autoritetet publike dhe disa shoqata gazetarësh në Shqipëri.¹¹¹

98 Intervista Nr. 16, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

99 Intervista Nr. 19, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 20.9.2019; Intervista Nr. 7, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 14.8.2019; Intervista Nr. 20, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 23.8.2019.

100 Intervista Nr. 20, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 23.8.2019; Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 16, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

101 Intervista Nr. 19, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 20.9.2019; Intervista Nr. 12, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 9.9.2019; Intervista Nr. 20, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 23.8.2019; Intervista Nr. 14, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019; Intervista Nr. 16, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

102 Marrë nga <https://historia-ime.com/?p=60908>

103 Përmbytja e gjeneruar nga përdoruesi mund të përbajë: imazhe, vlerësime, komente, artikuj në blog, ndihmesë fjalori dhe videoklipe.

104 Marrë nga <https://www.gazetatema.net/2019/05/18/fotot-parada-e-lgbti-shkembehen-puthje-dhe-perqafime-ne-qender-te-tiranes/>

105 Marrë nga <https://www.botasot.info/tirana-shqiperia/740632/digjet-streha-e-lgbt-ne-tirane/>

106 Marrë nga <http://shekulli.com.al/u-largova-nga-shqiperia-kercenuan-se-varnin-e-digjnin-acid/>

107 Intervista Nr. 19, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 20.9.2019; Intervista Nr. 16, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019; Intervista Nr. 20, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 23.8.2019.

108 Intervista Nr. 13, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 26.8.2019.

109 Siç parashikohet në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (1995, i ndryshuar në vitin 2017). Intervista Nr. 21, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 10.9.2019.

110 Intervista Nr. 20, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 23.8.2019; Intervista Nr. 19, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 20.9.2019.

111 Marrë nga <https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/2019-English-HRR.pdf>

Sfida më e madhe për sigurinë fizike të MDNJ-ve, veçanërisht për ata që punojnë në media, është mungesa e **masave të duhura të mbrojtjes** në vendin e punës. Kjo nënkupton se gazetarët nuk janë të sigurt gjatë punës së tyre dhe janë të pambrojtur kundrejt ngacmimeve ose sulmeve nëse investigojnë shkelje të një institucioni ose individit. Problemi i dytë madhor është **pasiguria ekonomike**, pasi shumë gazetarë nuk paguhën rregullisht për arsye se nuk kanë një kontratë të vlefshme. **Pagat e gazetarëve vonohen** me qëllim që t'i mbajnë peng dhe t'i detyrojnë të zhvillojnë një sens vetëcensurimi.¹¹² Ka kanale televizive private që nuk i paguajnë punonjësit e tyre për disa muaj me radhë. Shembujt e mëposhtëm përshkruajnë disa nga sfidat e përditshme me të cilat ndeshen mbrojtësit e të drejtave të njeriut:

Gazetarët zakonisht ngurrojnë që të ndërmarrin veprime ligjore kundër individëve të rëndësishëm, të cilët pengojnë punën e tyre. Zakonisht, ata kanë frikë që ta përshkallëzojnë konfliktin, prandaj zgjedhin vetëcensurimin. Nëse nuk zbaton urdhrat e punëdhënësit, gazetari mund të pushohet lehtësisht nga puna. (Intervista Nr. 3, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 27.8.2019).

Kërcënimet online janë bërë diçka e zakonshme, prandaj nuk i marrim më parasysh, pasi ato janë bërë tashmë pjesë e jetës sonë sociale. [...], Punëdhënësi im më ka ushtruar presion të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke më kërcënuar se do të më pushonte nëse nuk i bindesha urdhrave të tij lidhur me botimin dhe censurimin e disa artikujve mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Edhe mbi kolegët e mi ushtrohet po i njëjti presion nga punëdhënësi e tyre. (Intervista Nr. 1, Përfaqësues i Medias, 12.8.2019)

Ndodh shpeshherë që aktivistët ose **gazetarët të pushohen nga puna** për shkak të detyrës së tyre, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Mungesa e një sindikate të posaçme për gazetarët sjell këtë situatë të pasigurt, pasi është e vështirë që gazetarët të negociojnë kontratat e tyre fiktive të punës. Pronarët e platformave të mëdha mediatike komunikojnë vazhdimisht me njëri-tjetrin mbi përmbajtjen e raportimit në kanalet e tyre. Nëse bëjnë diçka që bie ndesh me interesin e pronarëve të tyre, gazetarët rrezikojnë të pushohen dhe **të hyjnë në listën e zezë që i pengon të përparojnë** në tregun mediatik.¹¹³

Gazetarja investigative Alida Tota është kërcënuar, përbaltur, pushuar nga puna dhe futur në listën e zezë që e pengon të përparojë në tregun e punës

Gazetarja investigative Alida Tota u pushua nga puna në një kanal televiziv privat, pasi kishte investiguar lidhjet e supozuara ndërmjet autoriteteve publike dhe një impianti riciklimi në landfillin e Sharrës në Tiranë, ku në vitin 2016 ndërroi jetë një i mitur. Tota u pushua nga puna në televizionin A1 News disa orë pasi kontaktoi zyrtarët publikë për të marrë opinionet e tyre.¹¹⁴ Tre vjet pas pushimit nga puna, emri i saj u bë pjesë e listës së zezë të tregut të punës dhe nuk ka arritur të gjejë punë në median tradicionale, pavarësisht se është kandidatë e denjë. Ajo ka marrë vazhdimisht kërcënime anonime me vdekje. Po ashtu, agresorët shënjestruan djalin e saj 13-vjeçar, duke e detyruar të kërkonte azil në Suedi. Ndonëse e ka paditur kanalën televiziv për pushim të padrejtë nga puna dhe dëmshpërblim pagash, ajo nuk iu kthye kurrë gazetarisë. Në vitin 2017, ajo e fitoi çështjen, por gjykata e rrëzoi pretendimin e saj se është pushuar për shkak të investigimit.¹¹⁵ Pas vdekjes së një punonjëse në po të njëjtin landfill dy vjet më vonë, Alida më në fund arriti të nxiste zhvillimin e një seance parlamentare me dyer të mbyllura, por shumë shpejt u persekutua nga një fushatë përbaltjeje nga gazetarët pro qeverisë, të cilët vinin në pikëpyetje profesionalizmin e saj.¹¹⁶

Në fakt, ata që e ngrenë zërin mund të bien pre e formave të ndryshme të presionit të ushtruar ose nga zyrtarët publikë ose nga persona anonimë, si në shembullin e mëposhtëm:

Në çështjen x¹¹⁷, pata presion nga zyrtarë të lartë e të fuqishëm, të cilët më luteshin të hiqja dorë nga çështja. Marrja e telefonatave kërcënuese u bë diçka e zakonshme për mua sa që u shndërrua thujse në rutinë. Situata rëndohet më shumë për faktin që ngritja e një çështje në gjykatë është një proces që merr shumë kohë, pasi gjyqtarët nuk ka shumë njohuri mbi krimin mjedisor. Përveç presionit nga institucionet qeveritare, ka pasur ndërhyrje edhe nga bizneset private. Madje njëherë mora edhe një kërcënim me vdekje, por nuk doja ta raportoja pasi personi kërkoi ndjesë dhe mosmarrëveshja midis nesh u zgjidh nëpërmjet një ndërmjetësi. Ky lloj intimidimi nuk pati asnjë efekt shkurajues tek unë. Unë do ta vazhdoj betejën time. (Intervista Nr. 6, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 13.8.2019)

Gazetarët ngurrojnë që të ngrenë padi në gjykatë për shkak të kohëzgjatjes së procedurave. Në një rast (akuza për shpifje në çështjen e Gjini Gjonit),¹¹⁸ vendimi u dha pas katër vjetësh e gjysmë, në një kohë kur nuk kishte më rëndësi. Shpeshherë, gazetarët përballen me rezistencë të fortë kur ngrenë padi në gjykatë. Ka pasur shumë raste kur gazetarët kanë pasur padi të rënda, të cilat janë rrëzuar shpejt nga prokurorët.¹¹⁹ Ka pasur edhe raste kur qeveria ka bërë ndryshime në kuadrin ligjor për të bllokuar, ose më keq, për të sulmuar ose heshtur kundërshtimin e MDNJ-ve.

Çështja “V” – Qeveria përdori kufizimet ligjore për të sulmuar dhe heshtur kundërshtimin e MDNJ-ve

Projekti i ashtuquajtur “V” u prezantua fillimisht në prill 2016 si një simbol modern. Gjatë gërmimeve, shoqëria e kontraktuar gjeti relike të fortifikimeve romake dhe osmane. MDNJ-të që punonin për çështjet mjedisore kontaktuan autoritetet përgjegjëse për ndërprerjen e punimeve, por nuk morën asnjë përgjigje. Gjatë debateve të vazhdueshme, MDNJ-të u intimiduan, ranë pre e presionit psikologjik, dhe, në disa raste, morën edhe kërcënime me vdekje për të hequr dorë ose për të ndaluar proceset gjyqësore. Megjithatë, MDNJ-të¹²⁰ vijuan me padinë e tyre kundër qeverisë vendore dhe institucioneve përkatëse të qeverisë qendrore. Dispozitat ligjore të ligjit¹²¹ iu lejonin OJF-ve të fillonin një çështje administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Vendimi ishte pezullimi i punimeve, mbështetur mbi faktin që projekti cenonte zonën arkeologjike. Menjëherë pas këtij vendimi, bashkia e apeloj çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit. Njëkohësisht, në qershor 2018, qeveria nxori një ligj të ri,¹²² i cili parashikonte se vetëm institucionet e specializuara mund të ngrinin padi për ndërtime në kundërshtim me ligjin.¹²³ Duke marrë parasysh dispozitat e reja, Gjykata e Apelit mori vendimin¹²⁴ se çështja nuk ishte kompetencë e OJF-ve. Me këtë interpretim, e drejta e OJF-ve për të pretenduar ose për të ngritur dyshime nuk ishte më e pranueshme. Thujse 2 vjet pas kësaj ngjarjeje, punimet vazhduan dhe zona arkeologjike është mbuluar tashmë nga betoni. Për t'i bërë kërkesat e tyre të pranueshme ligjërisht (për të ngritur padi), MDNJ-të themeluan një institucion të ri të specializuar, sipas parashikimeve të ligjit të ri. Tashmë, çështja i ka kaluar Gjykatës së Lartë për gjykim të mëtejshëm në themel.¹²⁵

Megjithatë, defekti më i madh i sistemit të drejtësisë¹²⁶, që pengon punën e MDNJ-ve dhe gazetarëve, është mungesa e mbrojtjes së burimeve të gazetareske. Nëse boton një artikull polemik mbështetur në dëshmi konfidenciale, gazetari mund të detyrohet nga gjykata që të bëjë publik emrin e individit. Kushdo mund ta padisë gazetarin në gjykatë duke e akuzuar për mashtrim, çka e detyron këtë të fundit të zbulojë burimin anonim.¹²⁷ Kjo situatë i shkurajon gazetarët që të përdorin burime anonime, siç i shkurajon edhe individët si burime të mundshme anonime që të zbulojnë informacione konfidenciale, pasi mund të vihen në rrezik:

Ka pasur raste kur gjykata na ka kërkuar të diskutojmë çështje personale në lidhje me deklaratat konfidenciale të informatorëve tanë. Gjykata e ka të drejtën t'ju kërkojë emrin ose çdo lloj informacioni, dhe me ligj ju kërkohet që t'i deklaroni ato. Duhet të ndryshojë sistemi për të siguruar që deklaratat e MDNJ-ve të shqyrtohen me kujdes, në mënyrë që të mos mbajnë përgjegjësi penale. Ndonëse gjithmonë duhet t'iu kërkohet të dëshmojnë, MDNJ-të duhet të trajtohen ndryshe nga qytetarët e tjerë gjatë procesit të marrjes në pyetje. (Intervista Nr. 21, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 10.9.2019)

Aspektet gjinore të sulmeve, ngacmimeve dhe kufizimeve ndaj

Kërcënimet për dhunë dhe intimidim nuk shënjestrojnë vetëm jetët personale të GMDNJ-ve, por edhe familjet dhe organizatat e tyre. Një nga të intervistuarat u shpreh se është intimiduar dhe ka marrë kërcënime me vdekje nëpërmjet telefonit, gjatë kohës që po ndihmonte një viktimë të dhunës në familje. Ajo beson se kërcënimet janë bërë nga ish-bashkëshorti i viktimës, por ajo nuk e vazhdoi çështjen më tej në Prokurori, pasi nuk donte ta bënte çështje publike. Bërja publike e këtij informacioni do të kishte qenë tepër e rrezikshme.¹²⁸

Një tjetër e intervistuar pohoi se ndodhte shpesh që ajo si GMDNJ, e cila mbronte të drejtat e komunitetit LGBTI+, të merrte mesazhe denigruese dhe kërcënime për dhunë seksuale nëpërmjet medias sociale. Ajo raporton raste të disa reagimeve homofobike, si grupet homofobike në Facebook, që përbëhen kryesisht nga djem të rinj, dhe faqet që bëjnë thirrje për dhunë (seksuale).¹²⁹ Reagimet homofobike shfaqin ankth dhe urrejtje ndaj komunitetit LGBTI+, çka konfirmon vlerat kombëtare mbizotëruese heteroseksiste dhe misogjiniste, që i bëjnë heteroseksualitetin dhe heteronormativitetin normë dominuese në shoqërinë shqiptare.

Gjithashtu, sulmet që shënjestrojnë familjarët e GMDNJ-ve përdoren shpeshherë si pengesë e efektshme kundrejt aktivizmit të tyre në të ardhmen. Një e intervistuar u shpreh se njëra nga koleget e saj u detyrua të linte punën, si pasojë e kërcënimeve të vazhdueshme që kishte marrë kundër familjes së saj. Për shkak të kësaj, ajo kërkoi azil politik jashtë Shqipërisë.¹³⁰ Këto sulme me bazë gjinore rrezikojnë sigurinë psikologjike dhe fizike të GMDNJ-ve, të cilat përballen me frikën se autorët do të hakmerren një ditë. Pandëshkueshmëria e këtyre sulmeve rëndohet më tej nga fakti se nuk ka mekanizma mbrojtëse me ndjeshmëri gjinore për GMDNJ-të.

120 Përfaqësues ligjorë të disa OJF-ve që punojnë për çështjet mjedisore.

121 Bazuar në Nenin 28(3) të Ligjit të mëparshëm Nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”.

122 Neni 81, pika 1 e Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore”.

123 Që nënkupton se vetëm institucionet specializuara, të cilat kanë nën kompetencën e tyre çështje të trashëgimisë arkeologjike dhe kulturore, ngrejne padi.

124 Gjykata Administrative e Apelit.

125 Intervista Nr. 6, Përfaqësues i Medias, 13.8.2019.

126 Reforma në gjyqësor është një nga kërkesat kryesore të BE-së në mënyrë që të fillojë negociatat për anëtarësim. Kjo reformë është në proces që prej vitit 2016. Pavarësisht ndikimit pozitiv që ajo pritet të ketë në sistemin gjyqësor në Shqipëri në planin afatgjatë, vendi nuk ka pasur Gjykatë të Lartë dhe Gjykatë Kushtetuese për më shumë se një vit. Kjo ka ndodhur për shkak të dorëheqjeve dhe procesit të vetingut, i cili largoi disa prej gjyqtarëve në detyrë. Për rrjedhojë, reforma ka penguar disa aksesin në drejtësi, në veçanti për grupet e cënueshme dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

127 Intervista Nr. 1, Përfaqësues i Medias, 12.8.2019; Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019.

128 Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019.

129 Intervista Nr. 19, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 20.9.2019.

130 Intervista Nr. 1, Përfaqësues i Medias, 12.8.2019.

112 Intervista Nr. 3, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 27.8.2019; Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019.

113 Intervista Nr. 1, Përfaqësues i Medias, 12.8.2019.

114 Marrë nga https://www.coe.int/en/web/mediafreedom/detailalert?p_id=sojdashboard_WAR_coesoportlet&p_p_lifecycle=0&p_p_col_id=column-3&p_p_col_count=10&_sojdashboard_WAR_coesoportlet_alertPK=28370908

115 Marrë nga <https://www.reporter.al/gjykata-vendos-pro-gazetares-tota-ne-gjyqin-kunder-televizionit>

116 Marrë nga https://rsf.org/sites/default/files/en_rapport_mafia_web_0.pdf

117 Emri i rastit nuk bëhet i ditur.

118 Marrë nga <https://balkaninsight.com/2018/06/01/tirana-court-dismisses-judge-s-defamation-claim-against-birn-06-01-2018/>

119 Intervista Nr. 2, Përfaqësues i Medias, 16.8.2019.

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut, në Shqipëri, duhet të gëzojnë mbrojtje të veçantë dhe lehtësira, duke marrë parasysh rreziqet me të cilat përballen në krye të detyrës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe demokracisë. Kjo analizë ka gjetur që përdoren metoda të ndryshme për të ushtruar presion dhe për të ngacmuar MDNJ-të, duke përmendur këtu tallje në internet, ngacmime dhe fushata përbaltjeje. Autoritetet shfrytëzojnë talljet për të formësuar opinionin publik, si p.sh. duke iu referuar gazetarëve si të politizuar, joprofesionalë ose si ‘kazan’. Fushatat publike të përbaltjes janë të zakonshme edhe për MDNJ-të. Nga ana tjetër, individët që presin të paguhet në fund të muajit janë të frikësuar, shfrytëzohen lehtësisht dhe nuk kanë guximin që të ngrenë zërin. Si rrjedhojë, MDNJ-të dhe gazetarët në Shqipëri bien pre e vetëcensurës, e cila vjen si pasojë e presionit nga politikanë të nivelit të lartë nga talljet, politika kufizuese editoriale dhe ndjenja e përgjithshme e mosbesimit në sistemin e gjyqësorit. Zyrtarët publikë kanë më shumë gjasë të përdorin kooptimin si një formë presioni, si p.sh. duke ofruar një vend pune në administratën publike në këmbim të heshtjes ose intimidimit të aktivistëve për t’i dhënë fund bashkëpunimit institucional ose financimit. Mundësitë për të mbështetur punën e gazetarëve të pavarur janë të pakta, veçanërisht nëse puna e tyre kritikon qeverinë. Për më tepër, ekzistojnë raste të sulmeve të drejtpërdrejta, duke përfshirë paditjen në gjykatë¹³¹, nga autoritete të njohura publike, të cilët i sulmojnë personalisht gazetarët, duke i kërcënuar që të ndërmarrin veprime të caktuara. Ndonëse korniza aktuale ligjore u lejon aktorëve të shoqërisë civile të veprojnë të lirë, pa ndërhyrje të pajustificuar të shtetit në strukturat qeverisëse apo aktivitetet e tyre,¹³² ndërhyrja e autoriteteve shtetërore për të ndaluar ose, në disa raste, për të kriminalizuar protestat, si dhe për të përdorur forma diskrete presioni kundër mbrojtësve të të drejtave të njeriut, mund të interpretohet si një formë indirekte e ndërhyrjes së shtetit në të drejtën për t’u organizuar dhe për të marrë pjesë në një tubim paqësor. Edhe pse çështjet nuk përfshijnë domosdoshmërisht të gjitha shkeljet dhe ngacmime me të cilat përballen grupe të ndryshme të mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri, ato nxjerrin në pah disa nga sfidat dhe kufizimet kryesore të vendit.

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut kanë më pak gjasë të ngrenë një padi apo të kallëzojnë një shkelje në gjykatë për arsye të ndryshme. Së pari, sistemi gjyqësor është tejte i politizuar dhe gjendet nën presion të vazhdueshëm politik. Përpos kësaj, niveli i besimit është mjaft i ulët dhe duket se ka ndikuar negativisht në qëndrimin e MDNJ-ve mbi efikasitetin dhe pavarësinë e sistemit. Ndonëse reforma e gjyqësorit është konsideruar nga shumë MDNJ si një arritje në përmirësimin e sundimit të ligjit, shumë prej tyre vazhdojnë të kenë një qasje pesimiste dhe mungesë besimi te gjyqësori.¹³³ Në disa raste, incidentet e raportuara ndaj aktivistëve të të drejtave të njeriut janë shoqëruar me hetime të paplota dhe mosndëshkimin e autorëve. Raportet tregojnë raste në të cilat autorët e shkeljeve të të drejtave të njeriut nuk janë ndjekur penalisht. Çështjet shpeshherë janë pushuar për shkak të mungesës së provave të prokurorëve për të vërtetuar se arsyeja e sulmeve ishte ushtrimi i detyrës nga ana e një MDNJ-je apo gazetari. Mungesa e hetimit dhe e ndjekjes penale në mënyrë efikase dhe efiente të akuzave për keqtrajtim dhe sjellje të papërshtatshme vazhdon të kontribuojë në një klimë frike dhe mosndëshkimi, për sa i përket çështjeve të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Së dyti, ngritja e çështjes përpara gjykatës shpesh mund të sjellë rezultate të kundërta, pasi në disa raste autorët nuk ndëshkohen dhe informacioni konfidencial i mbajtur nga prokurorët u zbulohet palëve të treta, duke rrezikuar kështu më shumë se jetën e një MDNJ-je. Ekziston një frymë e përgjithshme mosbesimi në mënyrën e funksionimit të gjykatave. Për këtë arsye, mbrojtësit e të drejtave të njeriut ngurrojnë të ngrenë një ankesë kundër autorëve. Ka raste në të cilat vërehet përdorimi i rrjeteve sociale për të ndërmjetësuar një konflikt. Së treti, pavarësisht faktit se ligji garanton akses në drejtësi për të gjithë individët, në praktikë sistemi i ndihmës juridike falas nuk është ende plotësisht funksional për individët pa burime financiare. Së katërti, procedurat e zgjatura gjyqësore cenojnë të drejtën e një individi për gjykimin e çështjeve në kohën e duhur. Përmendim këtu një rast në të cilin vendimi u dha pothuajse katër vite e gjysmë më vonë, në një kohë kur ai nuk ishte më i dobishëm. Së pesti, për shkak të presionit politik dhe frikës së prokurorëve nga ndëshkimi, ata priren të shmangin hetimet ndaj zyrtarëve të lartë publikë (rasti i akuzave për shpifje të ngritura nga Gjin Gjonit).¹³⁴ Dhe së fundi, shqetësimi më i madh lidhet me përfshirjen e sistemit gjyqësor në një nivel të lartë korrupsioni dhe presioni politik, e cila cenon pavarësinë dhe integritetin e këtyre institucioneve. Prokurorët nuk arrijnë të fillojnë hetime për çështjet e pretenduara të shkeljeve të të drejtave të njeriut ose, shpesh, çështje të tilla pushohen, ndoshta për shkak të burimeve të kufizuara, infrastrukturës ose burimeve njerëzore.

Mekanizmat ekzistues për parandalimin dhe mbrojtjen kundër formave të ndryshme të shkeljeve ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut, si edhe për ndjekjen penale të tyre, nuk janë efikase dhe zbatimi i tyre është mjaft i dobët. Sipas gjetjeve, mekanizmat e duhur mbrojtës për MDNJ-të kanë ende nevojë për përmirësim.

Rekomandime

Autoritetet publike

- ▶ Hartimi i një programi efikas mbrojtjeje për MDNJ-të në rrezik, veçanërisht për GMDNJ-të dhe LGBTI + MDNJ-të, të cilët përballen me kërcënime serioze, duke u siguruar mbrojtje të përkohshme dhe të menjëhershme gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut të situatës së tyre. Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë duhet të shërbejë si një pikë kontakti për diskutimin publik dhe gjetjen e zgjidhjeve, me qëllim adresimin e nevojave të mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Ai duhet të nxisë zhvillimin e metodologjisë së standardizuar dhe periodike të raportimit për shkeljet e të drejtave të njeriut, si dhe të ndërmarrë një plan veprimi për të adresuar shqetësimet e tyre.
- ▶ Kodi Penal i Shqipërisë duhet të ndryshohet duke përfshirë dispozita që do të mbronin në mënyrë efikase mbrojtësit e të drejtave të njeriut nga ngacmime vetëm sepse ushtrojnë detyrën/veprimtarinë e tyre. Pra, ata duhet të përfshihen në kategorinë e veçantë të “grupeve në rrezik” dhe kërcënimet me dhunë kundër tyre duhet të konsiderohen si rrethanë rënduese në cilësimin e veprave penale.
- ▶ Kuadri ligjor për tubimet duhet të ndryshohet për të sqaruar dhe standardizuar procedurat e njoftimit, duke përfshirë tubimet spontane dhe kundërtubimet, si dhe për të dhënë udhëzime për apelimin dhe korrigjimin e vendimeve në lidhje me kufizimet e tubimeve.
- ▶ Pavarësia e mediave duhet të sigurohet duke angazhuar përfaqësuesit e mediave dhe grupet e tjera të interesit në procesin e konsultimit për “paketën antishpifje”. Gjithashtu, qeveria duhet të marrë në konsideratë dispozitat që do të siguronin respektimin e plotë të standardeve ndërkombëtare për lirinë e shprehjes dhe vetë-rregullimin e mediave.
- ▶ Mbrojtësve të të drejtave të njeriut duhet t’u jepet përparësi gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit për MDNJ-të dhe roli i tyre duhet të përmirësohet, duke vendosur mekanizma efikas për bashkëpunim në nivel qendror dhe vendor.
- ▶ Roli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe roli i Avokatit të Popullit duhet të përforcohet në mënyrë që të mund të monitorojnë nga afër dhe të shqyrtojnë sistematikisht ankesat dhe shkeljet kundër mbrojtësve të të drejtave të njeriut, si dhe të jenë më proaktivë në adresimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në tërësi.
- ▶ Kuadrot ligjore dhe dhe institucionale duhet të përmirësohen, si dhe të rritet ndërgjegjësimi për mosdiskriminimin dhe mbrojtjen e GMDNJ-ve dhe LGBTI + MDNJ-ve. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkon ndryshime për të adresuar qartë çështjen e zhvendosjes së barrës së provës, veçanërisht në çështjet e diskriminimit me bazë gjinore ose për shkak të identitetit gjinor.
- ▶ Duhet të sigurohet mbrojtja e MDNJ-ve ndaj ngacmimeve, kriminalizimit, si dhe arrestimit arbitrar dhe burgosjes. MDNJ-të duhet të përfitojnë nga masa të posaçme procedurale ose autorizime, si p.sh. të mos u nënshtrohen sanksioneve penale ose administrative kur u kërkohet të dëshmojnë në procese gjyqësore, ose mbrojtjen e konfidencialitetit të burimit të informacionit, kur ata janë të detyruar nga gjykata të zbulojnë këtë të fundit. Kjo gjë nënkupton një trajtim ndryshe nga qytetarët e tjerë.
- ▶ Në mënyrë që organet ligjzbatuese dhe gjyqësori të mund të kryejnë hetime të menjëhershme, të ndjekin penalisht dhe të ndëshkojnë autorët që sulmojnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut, efikasiteti, transparenca dhe sensibilizimi i këtyre organeve duhet të rritet.
- ▶ Brenda strukturave ekzistuese (Avokati i Popullit ose Komisioneri), duhet të ngrihet një strukturë kombëtare mbrojtjeje, e cila do të trajtonte ankesat në lidhje me format e ndryshme të shkeljeve të kryera kundër mbrojtësve të të drejtave të njeriut, duke monitoruar njëkohësisht situatën e këtyre të fundit.
- ▶ Është e nevojshme të krijohet një mjedis më i favorshëm për OJQ-të, duke miratuar një procedurë të thjeshtuar dhe të decentralizuar të regjistrimit të tyre, e cila përjashton procedurat gjyqësore, duke i lehtësuar kështu nga pengesat fiskale dhe duke hequr dispozitën e detyrueshme për të pasur të paktën një punonjës me kohë të plotë të përhershëm.

¹³¹ Duke përfshirë akuzat penale, paditë civile dhe procedurat administrative.

¹³² Neni 7 i Ligjit Nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”.

¹³³ Intervista Nr. 17, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, 3.9.2019; Intervista Nr. 14, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, më 26.8.2019.

¹³⁴ Marrë nga <https://balkaninsight.com/2018/06/01/tirana-court-dismisses-judge-s-defamation-claim-against-birn-06-01-2018/>

Media


- ▶ Kapacitetet e mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe gazetarëve duhet të rriten, duke zbatuar një qasje më proaktive në mbulimin e çështjeve dhe artikujve me në qendër shqetësimet për të drejtat e njeriut.
- ▶ Mediat duhet të miratojnë mekanizma më efikas të vetë-rregullimit për të adresuar në mënyrë të përshtatshme çështjet etike dhe frenimin e gjuhës së urrejtjes, për shembull duke filtruar rregullisht komentet e përdoruesve.
- ▶ Për të mbrojtur të drejtat e punës së gazetarëve, duhet të krijohen sindikatat e gazetarëve.
- ▶ Pavarësia dhe profesionalizmi i AMA-së duhet të përforcohen duke kufizuar ndërhyrjet dhe presionin politik gjatë procedurave zgjedhore të anëtarëve të saj. Sugjerohet edhe përmirësimi i transparencës dhe besueshmërisë publike.

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut

- ▶ Me qëllim përforcimin dhe promovimin e rolit të MDNJ-ve, duhet të përmirësohet rrjeti kombëtar i tyre. Ky rrjet mund të shërbejë edhe si pikë kontakti për koordinimin dhe përmirësimin e të gjitha përpjekjeve që synojnë mbrojtjen e tyre.
- ▶ Për të përmirësuar kornizën e përgjithshme në lidhje me procesin e hartimit ligjor të të drejtave të njeriut dhe konsultimet për hartimin e politikave me MDNJ-të, duhet të bëhen kërkesa më këmbëngulëse. Në mënyrë që të krijohet një mekanizëm ligjërishit i detyrueshëm që do të sigurojë pjesëmarrje më kuptimplotë dhe të qëndrueshme të MDNJ-ve në proceset e vendimmarrjes dhe hartimit të politikave, duhet të propozohen ndryshime në Ligjin Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.
- ▶ Duhet të përforcohet bashkëpunimi i MDNJ-ve me organet përkatëse parlamentare dhe pozicioni i tyre në punën e këtyre organeve.
- ▶ Ndërgjegjësimi publik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut duhet të rritet.

Komuniteti ndërkombëtar

- ▶ Duhet të sigurohet vazhdimësia e një roli aktiv në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut përmes monitorimit dhe raportimit periodik të këtyre rasteve. Raporti i Progresit të KE-së mund të sigurojë informacione mbi gjendjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë ecurinë në lidhje me masat e mbrojtjes, veçanërisht për as i përket GMDNJ-ve dhe LGBTI + MDNJ-ve.
- ▶ Qeveria shqiptare duhet të nxitet të krijojë një mjedis favorizues për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, ndër të tjera përfshirjen më proaktive të OJQ-ve në procesin e hartimit të politikave dhe krijimin e mekanizmave efikase për të adresuar, në kohën e duhur, shkeljet e të drejtave të njeriut.
- ▶ Duhet të përforcohen kapacitetet teknike dhe financiare të organizatave të shoqërisë civile, në mënyrë të veçantë në programet për mbrojtësit e të drejtave të njeriut.
- ▶ Për të kuptuar dhe adresuar pretendimet e mbrojtësve të të drejtave të njeriut për një sërë temash, duhet të organizohen aktivitete për përmirësimin e kapaciteteve me ekspertë dhe grupe të tjera interesi.



M B R O J T È S I T

T È T A V E

D R E J T E R I U T

T È N J N È

N È K A N I N

B A L L K A N I N

P E R È N D I M O R

